



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVA	
MINISTRIA E SHËNDETËSISË-MINISTARSTVO ZDRAVLJA-MINISTRY OF HEALTH	
Njësia Org Org. Unit	2.2
Nr. i faqeve Stranica No. pages	- 8 -
Nr. Prot. Prot. No.	05-361
Data: Datum	23/01/2023
Prishtinë / a	

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Shëndetësisë-Ministarstvo Zdravstva-Ministry of Health
Departamenti Ligjor/Pravni Departament/Legal Departament

Për :	Kryetarin e Komunës së Mamushës Kryesues i Kuvendit të Komunës së Mamushës
Kopje:	Njesisë për Administrimin e Dokumenteve në MAPL Njesisë për administrimin e Dokumenteve në Komunë
Përmes:	Dr. Arben Vitia, Ministër i Shëndetësisë Dr. Naim Bardiqi, Sekretar i Përgjithshëm në MSH
Nga:	Afërdita Hoxha, Zëvendësuese e Drejtorit të Departamentit Ligjor në MSH
Zyrtarët përgjegjës:	Dr. Albana Morina, Udhëheqëse e Divizionit të Kujdesit Parësor Shëndetësor / MSH
1. Zyrtari konfirmues i vlerësimit	
2. Zyrtari hartues i vlerësimit ligjor	Kadrije Sherifi, zëvendës Udhëheqëse e Divizionit për mbikëqyrje dhe zbatim të Legjislacionit / MSH
Lënda:	Shqyrtim i ligjshmërisë e aktit të Kuvendit të Komunës së Mamushës
Lloji i aktit:	Rregullore për taksa komunale

I nderuar z. Kryetar ,
I nderuar Kryesues ,

Ministria e Shëndetësisë në mbështetje të nenit 81.4 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, Rregulloren e Qeverisë Nr. 02/2021 për Fushat dhe Përgjegjësitë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, si dhe Rregulloren nr. 06/2021 për ndryshimplotësimin e Rregullores (QRK)nr. 10/2019, për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, MSH, me datë: 13/01/2023 ka pranuar për vlerësim të ligjshmërisë Rregulloren për taksa, ngarkesa dhe gjoba me Nr.01-024-22 të nxjerrë nga Kuvendi i Komunës së Mamushës.

Ministria e Shëndetësisë (MSH), ka bërë shqyrtimin e ligjshmërisë së aktit në fjalë:

KONFIRMON

Rregullorja për taksa, ngarkesa dhe gjoba me Nr.01-024-22 e nxjerrë nga Kuvendi i Komunës së Mamushës, është pjesërisht në pajtueshmëri me legjislacionin në fuqi. Në rregulloren e aprovuar nuk janë të përfshira pika 2 dhe 3 sipas Shtojces 1 - a (Tabela e bashkë-pagesave për shërbimet shëndetësore në nivel parësor të Udhëzimit Administrativ Nr.04/2007

Mbledhja dhe shfrytëzimi i mjeteve nga bashkë-pagesat e shfrytëzuesve të shërbimeve shëndetësore dhe të hyrave vetanake të Institucioneve Shëndetësore).


Arsyetim

Ministria e Shëndetësisë, pas shqyrtimit të përmbajtjes së aktit të Komunës si më sipër, konstaton se Rregullorja e miratuar në Kuvendin e Komunës së Mamushës, është pjesërisht në pajtueshmëri me Udhëzimin Administrativ Nr.04/2007 Mbledhja dhe shfrytëzimi i mjeteve nga bashkë-pagesat e shfrytëzuesve të shërbimeve shëndetësore dhe të hyrave vetanake të Institucioneve Shëndetësore sipas Shtojces 1 - a (Tabela e bashkë-pagesave për shërbimet shëndetësore në nivel parësor.

VËREJTJE: Çmimet për certifikatat mjekësore sipas pikës 16 të Rregullorës për taksa, ngarkesa dhe gjoba me Nr.01-024-22 e nxjerrë nga Kuvendi i Komunës së Mamushës, duhet të jetë sipas Udhëzimit Administrativ (MSh) Nr.04/2013 - Certifikatat shëndetësore, Shtojca 1 - Çmimorja për certifikata shëndetësore. ✓

VËREJTJE: Pika 22 (ndërhyrjet operative paradontale) dhe pika 23 (nxjerrja e dhëmbit në mënyrë operative nuk janë të pjesë e shërbimeve të nivelit parësor të kujdesit shëndetësor. ✓

Me respekt!



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

*Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve - Ministarstvo Finansija, Rada i Trasfera -
Ministry of Finance, Labour and Transfers*

Për:	Abdülhadi Krasniç, Kryetare e Komunës së Mamushës		
	Necmedin Morina, Kryesues i Kuvendit të Komunës		
Kopje:	Elbert Krasniqi, Ministër në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal		
	Venera Çerkini, Zv. Sekretare e Përgjithshme, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal		
	Njësia për Administrimin e Dokumenteve, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal		
Përmes:	Resul Makreshi, Zv. Ministër në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve		
	Enis Spahiu, Zv. Sekretar i Përgjithshëm, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve		
Nga:	Klit Shala, Zv. Drejtor i Departamentit Ligjor, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve	Datë:	24.01.2023
Zyrtarët përgjegjës:	Bora Duli, Zytare e Lartë Ligjore, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve		Referencë:
1. Zyrtari hartues i vlerësimit ligjor			12/2023
Lënda:	Kërkesë për rishqyrtim të aktit të Komunës së Mamushës		
Lloji i aktit:	Rregullore		

I nderuari Kryetar z. Krasniç,
I nderuari Kryesues z. Morina,

Në pajtim me Rregulloren (QRK) Nr. 10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, plotësuar dhe ndryshuar me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021, e në bazë të

kompetencave ligjore të Ministrisë, të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregulloren (QRK) Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, plotësuar dhe ndryshuar me Rregulloren (QRK) Nr. 04/2021, Departamenti Ligjor i Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve, ka pranuar për shqyrtim të detyrueshëm të ligjshmërisë, ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr. 03/L-05 për Vetëqeverisje Lokale, aktin komunal si në vijim:

<i>Rregulloren Nr. 02-165/2022, për taksa, ngarkesa, tarifa dhe gjobat komunale</i>
<i>I miratuar më datë 27.12.2022</i>
<i>I parashtruar për shqyrtim në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal më datë 11.01.2023</i>
<i>I dërguar për shqyrtim në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve më datë 12.01.2023</i>

Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve (këtej e tutje referuar si “Ministria”), pas shqyrtimit të përmbajtjes së aktit të mësipërm të Komunës së Mamushës, jep konstatimet e mëposhtme:

1. Komuna e Mamushës, me anë të aktit administrativ që është subjekt i shqyrtimit, ka synuar miratimin e rregullores për taksa komunale.
2. Ligji Nr. 03/L-049 për Financat e Pushtetit Lokal (këtej e tutje referuar si “Ligji”) e ushtron dhe/ose aplikon parimin e pavarësisë financiare të komunave kur të njëjtat zbatojnë kompetencat vetanake komunale, të precizuara më detajisht me nenin 4 të këtij Ligji.
3. Në esencë, me pavarësi financiare të komunave nënkuptohet e drejta e tyre që të posedojnë burime të mjaftueshme financiare, e me të cilat mund të disponojnë lirshëm përgjatë ushtrimit të kompetencave të tyre, kështu që ato në mënyrë të pavarur t’i rregullojnë dhe menaxhojnë burime financiare të cilat rrjedhin nga të hyrat vetanake komunale, në pajtim me nenin 2 të Ligjit.
4. Në kontekst të të hyrave vetanake, neni 8 i Ligjit në mënyrë taksative i precizon burimet të cilat konsiderohen si kategori e të hyrave vetanake të komunave. Në këtë drejtim, taksat komunale, gjobat, pagesat tjera për shërbime publike të ofruara nga komuna, konsiderohen si kategori e të hyrave vetanake komunale, ashtu të trajtuara dhe me aktin administrativ komunal që është subjekt i shqyrtimit.
5. Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve ka shqyrtuar të gjitha taksat komunale të cilat bien në fushëveprimin e saj, sipas Ligjit për Financat e Pushtetit Lokal dhe ligjeve tjera relevante për aktin komunal dhe ka evidentuar në Nenin 8, pikën 8.99 se Komuna ka caktuar tarifën për regjistrimin e barës në tatimin mbi pronën e paluajtshme, tarifë e cila nuk është në përputhje me legjislacionin në fuqi për tatimin në pronë, pasi që barra tatimore për tatimin në pronë nuk është më në fuqi.

6. Mbi këto sqarime, Ministria vlerëson se Rregullorja është në kundërshtim me legjislacionin në fuqi.

Marrë për bazë konstatimet e mësipërme, Ministria kërkon nga Komuna e Mamushës ndërmarrjen e veprimeve konkrete, brenda tridhjetë (3) ditëve nga data e pranimi të kërkesës për rishqyrtim të aktit, në mënyrë që masa e përcaktuar e komunës të harmonizohet me dispozitat ligjore në fuqi.

Ministria mbetet në dispozicion të Komunës së Mamushës dhe/apo Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal për çfarëdo sqarimi të mëtejshëm lidhur me këtë vlerësim.

Me respekt!

Interpretimi i dhënë nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve përkitazi me këtë çështje mbështetet vetëm në këndvështrimet që prekin fushëveprimin legjislativ të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve



Republika e Kosovës – Kosova Cumhuriyeti
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Mamuša Beledijesi – Komuna e Mamushës
Opština Mamuša – Municipality Of Mamusa



01 Nr. 008-23
Datë: 28.04.2023
Mamushë

Në bazë të nenit 12 paragrafi 1 dhe 2 Pika (c) neni 24 paragrafi 24.2 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-40, lidhur me nenin 2 dhe 8 Pika a) dhe b) të Ligjit Për Financat e Pushtetit Lokal Nr.03/L-049 si dhe nenit 18 paragrafi 1 pika 7, nenit 23 Paragrafi 23.1 Pika c) neni 45 Paragrafi 45.1 Pika g) dhe neni 63 Paragrafi 63.2, Statutit të Komunës së Mamushës 01.12.2008, Shkresën e Ministrisë së Financave nr të protokolit 64-1/2023 si dhe Shkresës së Ministrisë së Shëndetësisë nr të protokolit 05-361-8 Kuvendi Komunal me datë 28.04.2023 nxorri këtë

V E N D I M

Për plotësim ndryshim të Rregullores për taksa, tarifa, ngarkesa administrative dhe shërbimeve të tjera komunale

I

Miratohet plotësim ndryshimi i vendimit i ***Rregullores për taksa, tarifa, ngarkesa administrative dhe shërbimeve të tjera komunal*** me nr 01- 024-022 në Komunën e Mamushës.

II

Fshihet neni 8 pika 8.99 i cili sipas shkresës së Ministrisë së Financave punës dhe transfereve pasi sipa shkresës së Ligjshmërsë është në këndërshtim me Ligjin për Financat e Pushtetit Lokal NR. 03/L-049

III

Shtohet çmimorja për certifikatat mjekësore në bazë të rekomandimeve të Ministrisë së Shëndetësisë në bazë të shkresës së Ligjshmërisë nr të protokolit 05-361-8 datës 23.01.2023.

IV

Fshihet pika 22 (ndërhyrjet operative paradontale) dhe pika 23 (nxjerrja e dhëmbit në mënyrë operative) duke u bazuar në shkresës së Ligjshmërisë nr të protokolit 05-361-8 datës 23.01.2023.



Republika e Kosovës – Kosova Cumhuriyeti
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Mamuša Beledijesi – Komuna e Mamushës
Opština Mamuša – Municipality Of Mamusa

Republika e Kosovës Kosova Cumhuriyeti Republika Kosova - Republic of Kosovo Mamuša Beledijesi - Komuna e Mamushës Opština Mamuša - Municipality of Mamusa	
Sh. - Dëse - Izlazna - Outgoing	
01	No.Nr. 024-22
27.12.2022	

Në bazë të nenit 12 paragrafi 1 dhe 2 Pika (c) neni 24 paragrafi 24.2 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-40, lidhur me nenin 2 dhe 8 Pika a) dhe b) të Ligjit Për Financat e Pushtetit Lokal Nr.03/L-049 si dhe nenit 18 paragrafi 1 pika 7, nenit 23 Paragrafi 23.1 Pika c) neni 45 Paragrafi 45.1 Pika g) dhe neni 63 Paragrafi 63.2, Statutit të Komunës së Mamushës 01.12.2008, Rregulloren e Punës së Kuvendit të Komunës, Kuvendi Komunal me datë 27.12.22 nxorri këtë

RREGULLORE

PËR TAKSA, TARIFA, NGARKESA ADMINISTRATIVE DHE SHËRBIMEVE TË TJERA KOMUNALE

2022



Republika e Kosovës – Kosova Cumhuriyeti
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Mamuša Belediyesi – Komuna e Mamushës
Opština Mamuša – Municipality Of Mamusa

Në bazë të nenit 12 paragrafi 1 dhe 2 Pika (c) neni 24 paragrafi 24.2 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-40, lidhur me nenin 2 dhe 8 Pika a) dhe b) të Ligjit Për Financat e Pushtetit Lokal Nr.03/L-049 si dhe nenit 18 paragrafi 1 pika 7, nenit 23 Paragrafi 23.1 Pika c) neni 45 Paragrafi 45.1 Pika g) dhe neni 63 Paragrafi 63.2, Statutit të Komunës së Mamushës 01.12.2008, Rregulloren e Punës së Kuvendit të Komunës, Kuvendi Komunal me datë 28.04.2023 nxorri këtë

RREGULLORE

PËR TAKSA, TARIFA, NGARKESA ADMINISTRATIVE DHE SHËRBIMEVE TË TJERA KOMUNALE

2022

RREGULLOREN
PËR PAGESËN E TAKSAVE, TARIFAVE DHE NGARKESAVE ADMINISTRATIVE
DHE SHËRBIMEVE TË TJERA KOMUNALE

Kapitulli I : Të përgjithshme

Neni 1

Me këtë rregullore përcaktohen lartësia e tarifave dhe ngarkesave administrative dhe shërbimeve të tjera komunale të cilat u ofrohen qytetarëve dhe bizneseve në territorin e Komunës.

Neni 2

Sipas kësaj rregullore, Komuna mund të vjelë të gjitha të hyrat në bazë të tarifave dhe ngarkesave.

Neni 3

Kjo rregullore përcakton në veçanti për secilën tarifë dhe ngarkesë detyrat dhe obligimet e çdo drejtorie dhe shërbimet së bashku me lartësinë dhe mënyrën e pagesës.

DREJTORIA E ADMINISTRATËS SË PËRGJITHSHME

Kapitulli II : Tarifat dhe Ngarkesat

Pjesa 1 : Çertifikatat

Neni 4

4.1	Dokumentet zyrtare	Lartësia e taksës €
4.1.1	Ekstrakt i lindjes	1.00
4.1.2	Certifikatat e lindjes	1.00
4.1.3	Certifikatat e vdekjes	1.00
4.1.4	Certifikatat e kurorëzimit	1.00
4.1.5	Certifikatat e Vendbanimit	2.50

4.2	Dokumentet e konfirmuara	Lartësia e taksës €
4.2.1	Certifikata e statusit martesor	5.00
4.2.2	Regjistrimi i mëvonshëm i lindur në librat e gjendjes civile	20.00
4.2.3	Regjistrimi i mëvonshëm i vdekjes në librat e gjendjes civile	50.00
4.2.4	Vërtetimi mbi lajmërimin – ç'lajmërimin e vendbanimit	1.00
4.2.5	Certifikata se personi është në jetë	1.00
4.2.6	Certifikata e bashkësisë familjare	2.50
4.2.7	Vërtetimet tjera për botën e jashtme	5.00
4.2.8	Certifikata e nënshtetësisë	2.00
4.2.9	Përmirësimi i emrit dhe mbiemrit (me gabimin e zyrtarit pala lirohet	5.00

	nga pagesa)	
4.2.1.0	Dërgimi i dokumenteve brenda Kosovës përmes faxit zyrtar (një faqe)	1.00
4.2.1.1	Dërgimi i dokumenteve jashtë Kosovës përmes faxit zyrtar (një faqe)	2.00
4.2.1.2	Ndërrimi i emrit apo i mbiemrit	5.00
4.2.1.3	Për konfirmim të statusit martesor	5.00
4.2.1.4	Certifikata e gjendjes familjare	2.50
4.2.1.5	Përpilimi dhe lëshimi i Aktvdekjes	5.00
4.2.1.6	Lëshimi i certifikatës mbi identitetin	3.00
4.2.1.7	Lëshimi i certifikatës mbi vendqëndrimin	2.00
4.2.1.8	Vërtetim që personi i caktuar nuk është banor i Mamushes	2.00
4.2.1.9	Lëshimi i vërtetimit mbi shpenzimet e varrimit	2.00
4.2.2.0	Gjetja - sigurimi i dokumenteve në arkivin e Komunës	1.00
4.2.2.1	Kërkesë për fitimin e shtetësisë	-
4.2.2.2	Kërkesë për lirim nga shtetësia	-
4.2.2.3	Ri-regjistrimet në LAL, LAV dhe LAM sipas vendimit të organit kompetent dhe sipas dokumentacionit të posaçëm (edhe nga bota e jashtme)	Pa pagesë
4.2.2.4	Kërkesa, parashtresa dhe ankesa	Pa pagesë

4.3	Tarifa për ceremoni martesore	10.00
4.3.1	Lidhja e kurorëzimit jashtë objektit të SHCK-së..... 30,00 euro , si dhe kompensimi në emër të mëditjeve në lartësi prej 15,00 euro për secilin zyrtar i cili është kompetent për përgatitjen ose zhvillimin e procedurës së lidhjes së martesës.	30.00
4.3.2	Për kurorëzimet të cilat bëhen jashtë orarit të punës dhe festave në SHCK-së 25.00 euro, si dhe kompensimi në emër të mëditjeve në lartësi prej 15,00 euro për secilin zyrtar i cili është kompetent për përgatitjen ose zhvillimin e procedurës së lidhjes së martesës.	25.00

4.4	Vërtetim i dokumenteve zyrtare	Lartësia e taksës €
4.4.1	Vërtetimi zyrtar, përshkrimeve dhe fotokopje (1 faqe me tekst)	1.00 €
4.4.2	Kopjet e vërtetuara të autorizimeve, lejeve dhe licencave	2.00 €

Neni 5

Zyrtarët nga Drejtoria për Administratë të Përgjithshme janë përgjegjës për këto shërbime dhe mbetet për obligim që zyrtarët e autorizuar (Qendra për Shërbim Qytetarëve) të bëjnë vjeljen, lëshimin e dëftesave dhe dorëzimin e pagesave në fund të orarit të punës Zyrtarit të të Hyrave vetanake të Drejtorisë për Buxhet dhe Financa, kurse zyrtari i të hyrave pas barazimit me zyrtarin e zyrës së pritjes bënë dorëzimin në xhirollogarinë e komunës.

Neni 6

Me prezantimin e dokumentit të dëshmisë, anëtarët e ngushtë të familjeve të dëshmorëve, invalidët e luftës dhe anëtarët e ngushtë të familjeve të tyre, veteranët e luftës dhe anëtarët e ngushtë të familjeve të tyre, anëtarët e ngushtë të familjeve të viktimave civile të luftës, personat me aftësi të kufizuara dhe personat që realizojnë ndihma sociale në Qendrën për Punë Sociale, këto kategori lirohen nga pagesa e të gjitha shërbimeve nga neni 4.1 deri neni 7.1 (përfshirë 4.3.1 dhe 4.3.2) të kësaj rregullore.

Neni 7

7.1	Shërbimi i arkivit historik	Lartësia e taksës €
7.1.1	Për gjetjen e lëndës në arkiv pas vitit 2005	5.00 €
7.1.2	Kopje të projekteve individuale dhe tjera, për çdo faqe te formatit A4	-
7.1.3	Kopje te projektit për çdo faqe te formatit A3	-
7.1.4	Vërtetimi i diplomës	-

DREJTORIA PËR ARSIM KULTURË RINI DHE SPORT

Pjesa 2

7.2. Udhëzimi administrativ 03/2013 lëshimi i dokumenteve dublikate nga institucionet edukative-arsimore dhe universitare.

7.2.1	Dëftesa duplikat	1 €
7.2.2	Diploma duplikat	1 €

7.3. Udhëzimi administrativ 11/2011 për participimin e vijuesve të arsimit dhe aftësimit për të rritur.

7.3.1	Për regjistrimin e vitit (për një klasë 100 €)	100 €
7.3.2	Për praktik profesionale	50 €
7.3.3	Provim diferencial	10 €
7.3.4	Për provimet përfundimtare te klasës, certifikatën	30 €
7.3.5	Për diplome të përfundimit të shkollimit	20 €

DREJTORIA PËR PLANIFIKIM, URBANIZËM DHE GJEODEZI - KADASTËR

Neni 8

Pjesa 3

8.1. Çmimorja e shërbimeve komunale kadastrale

Udhëzim administrativ Nr.05/2012-MMPH për tarifat e shërbimeve dhe produkteve kadastrale të ofruara nga zyrat kadastrale komunale dhe kompanitë gjeodete të licencuara

Nr.i Tarifës		Vlera €
Ndërrimi i kulturave të parcelave		
8.2.	Ndërrimi i kulturës të një parcele pa matje	10.00
8.3.	Për çdo parcele tjetër që kufizohet me të	5.00
8.4.	Ndërrimi i kulturës në një parcele me matje	75.00
8.5.	Për çdo parcele tjetër që kufizohet me të	25.00
Ndarja e Parcelave		
8.6.	Ndarja e një parcele sipas gjendjes faktike në teren deri në 0.50 ha	75.00
8.7.	Për çdo ndarje në pjesë tjetër	25.00

8.8.	Ndarja e një parcele sipas gjendjes faktike në teren deri në 0.50-1.0 ha	100.00
8.9.	Ndarja e një parcele sipas gjendjes faktike në teren deri në 1.0-5.0 ha	150.00
8.10.	Ndarja e parcelës në pjesë të përcaktuara më pare	80.00
8.11.	Ndarja në më tepër se dy pjesë të përcaktuara më parë për çdo pjesë	40.00
8.12.	Ndarja e komplekseve në sip. 5-10ha në dy pjesë	200.00
8.13.	Për çdo ndarje në pjesë tjetër	100.00
8.14.	Ndarja e komplekseve me sip. mbi 10 ha, në dy pjesë	500.00
8.15.	Për çdo ndarje në pjesë tjetër	200.00
Bashkimi i parcelave		
8.16.	Bashkimi i parcelave pa matje	20.00
8.21.	Për çdo parcele tjetër në kufi	10.00
Matja e ndërtesave		
8.23.	Matja për një ndërtesë individuale për 1m ² të bazës gjeodezike	0.50
8.19.	Çdo ndërtesë tjetër në të njëjtën parcele 1m ² të bazës gjeodezike	0.25
8.20.	Ndërtesë banimi kolektivë për 1m ²	0.50
8.21.	Çdo ndërtesë tjetër në të njëjtën parcelë	0.50
8.23.	Ndërtesa afariste për 1m ²	0.70
8.23.	Çdo ndërtesë tjetër në të njëjtën parcelë për 1m ²	0.70
8.23.	Ndërtesa banesore- afariste për 1m ²	0.7
8.25.	Çdo ndërtesë tjetër në të njëjtën parcelë për 1m ²	0.50
8.26.	Ndërtesë e administratës qeveritare dhe publike për 1m ²	0.50
8.27.	Për çdo ndërtesë tjetër në të njëjtën parcelë për 1m ²	0.50
8.28.	Objektet për sport dhe rekreacion (stadium, halla sportive etj.)	0.50
8.29.	Objektet kulturore dhe fetare për 1m ²	0.30
8.30.	Për çdo ndërtesë tjetër në të njëjtën parcelë për 1m ²	0.50
Matjet e pjesëve të ndërtesave		
8.31.	Hapësirat banesore dhe përpilimi i skicave për 1m ²	0.80
8.32.	Kati me skicat e njëjësive të veçanta për m ²	0.70
8.33.	Hapësirat afariste dhe përpilimi i skicës për 1m ²	1.00
8.34.	Ndarja e hapësirave banesore dhe përpilimi i skicës për 1m ²	0.75
8.35.	Ndarja e hapësirës afariste dhe përpilimi i skicës për 1m ²	0.75
Matjet e përvojave		
8.36.	Përvoja nëntokësore për m gjatësi	0.50
8.37.	Përvoja mbitokësore për m gjatësi	0.25
8.38.	Objektet nëntokësore	100.00
8.39.	Për çdo objekt tjetër	50.00
8.40.	Tunelet për metër gjatësi	5.00
Përcaktimi i kufijve të parcelave		
8.41.	Për një parcelë me sipërfaqe deri 0.50 ha	80.00
8.42.	Për sipërfaqe prej 0.50-1.00 ha	100.00
8.43.	Për çdo hektar tjetër mbi 1ha	60.00
8.44.	Për parcelat urbane sipas plan urbanistik pas marrjes së pëlqimit nga drejtoria	120.00
Rregullimi i kufijve të parcelave		
8.45.	Për një parcele me sip. deri në 0.50 ha	40.00
8.46.	Për sip. prej 0.50 ha deri 1.00 ha	50.00
8.47.	Për çdo hektar tjetër	30.00
Dhënia e dëshmive nga baza e të dhënave kadastrale tekstuale apo grafike sipas kërkesave të		

palëve nga ZKK		
8.48.	Dhënia e vërtetimeve të ndryshme	3.00
8.49.	Çertifikata mbi pronën	4.00
8.50.	Kopja e planit A ₄ për një parcelë	5.00
8.51.	Për çdo parcelë tjetër	2.00
8.52.	Kopja e hartave kad.A ₀ ,leter e thjesht ,horizontal. (Përpjesa: 1:500, 1:1000, 1: 2500 e 1:5000)	20.00
8.53.	Historiati për një parcelë	30.00
Punët e zyrës sipas kërkesave të palëve		
8.54.	Identifikimi I njësive kadastrale në teren-për një njësi	20.00
8.55.	Për çdo njësi tjetër në kufi	5.00
8.56.	Kontrollimi dhe regjistrimi në regjistër i të dhënave nga terreni për një njësi kadastrale	20.00
Punët e veçanta gjeodezike		
8.57.	Bartja në teren e të dhënave nga planet urbanistike për objektet individuale për 1m ²	0.50
8.58	Bartja në teren e të dhënave nga planet urbanistike për objekte banimi kolektiv apo afarist për 1m ²	0.50
Punët tjera sipas kërkesave të palëve (identifikime të njësive kad.e tjera)		
Baza Gjeodezike		
Pikat Trigonometrike:		
8.59	Koordinatat Y, X ,me përshkrim	5.00
Pikat Lidhëse:		
8.60	Koordinatat Y, X , me përshkrim	4.00
Pikat Poligonale:		
8.61	Koordinatat Y, X, Z me përshkrim	3.00
Pikat Reper:		
8.62.	Koordinatat Y, X, Z me përshkrim	5.00
Pikat në linjë		
8.63.	Koordinatat Y, X, Z	2.00
Pikat e detajit		
8.64.	Koordinatat Y, X	1.00
8.65	Vendosja e pikave trigonometrike	50.00
Regjistrimi pronësisë, posedimit, në bazë të transaksioneve (shitblerjes		
UDHEZIMI ADMINISTRATIV NR. AKK 08/2014		
8.66	Për vlerën e transaksionit deri në 10,000 € paguhet taksa prej:	20.00
8.67	Për vlerën e transaksionit prej 10,000 € deri në 30,000 € paguhet taksa prej:	30.00
8.68	Për vlerën e transaksionit prej 30,000 € deri në 50,000 € paguhet taksa prej:	35.00
8.69	Për vlerën e transaksionit prej 50,000 € deri në 100,000 € paguhet taksa prej:	50.00
8.70	Mbi vlerën 100,000 €,për çdo 50,000€ tejkallim paguhet vlere prej 30 € por shuma e taksës së përgjithshme nuk mund të kaloj vlerën e 300 €.	
8.71	Po që se vlere e kontratës–transaksionit është e pavlerësushme paguhet taksa:	70.00
Regjistrimi i pronësisë, posedimit, në bazë të dokumentit mbi dhuratën		

8.72	Nëse në dokumentin (kontratën) mbi dhurimin e pronës së paluajtshme e që dhuratëmarrësi është anëtar i familjes apo pasardhës i dhuratëdhënësit e që është caktuar vlera e pronës, në këto raste do të paguhet 30% taksa-tarifa për çdo pronar-posedues që fiton të drejtën mbi pronën e paluajtshme sipas dhurimit, sipas tarifës të përcaktuar në pikat (; 8.65; 8.66,8.67,8.68,8.69 ,8.70).
8.73	Nëse në dokumentin (kontratën) mbi dhurimin e pronës së paluajtshme e që dhuratëmarrësi nuk është anëtar i familjes apo pasardhës i dhuratëdhënësit e që është e caktuar vlera e pronës në këto raste do të paguhet taksa-tarifa për çdo pronar-posedues që fiton të drejtën mbi pronën e paluajtshme sipas dhurimit, sipas tarifës të përcaktuar në pikat (; 8.65; 8.66,8.67,8.68,8.69 ,8.70).
8.74	Nëse në dokumentin (kontratën) mbi dhurimin e pronës së paluajtshme e që dhuratëmarrës janë anëtarët e familjes së ngushtë të dhuratëdhënësit ,ndërsa nuk është e caktuar vlera e pronës në kontratë, në këto raste do të paguhet taksa-tarifa në shumë prej 50 € për çdo pronar-posedues që fiton të drejtën mbi pronën e paluajtshme sipas dhurimit.
8.75	Nëse në dokumentin (kontratën) mbi dhurimin e pronës së paluajtshme e që dhuratëmarrës nuk janë anëtarët e familjes së ngushtë të dhuratëdhënësit , ndërsa nuk është e caktuar vlera e pronës në kontratë, në këto raste do të paguhet taksa-tarifa në shumë prej 80€ për çdo pronar-posedues që fiton të drejtën mbi pronën e paluajtshme sipas dhurimit.

Regjistrimi i pronësisë, posedimit, në bazë të dokumentit të organeve administrative dhe gjyqësore mbi njohjen e të drejtës së pronësisë-posedimit.

8.76	Regjistrimi i të drejtave mbi pronën e paluajtshme e cila fitohet në bazë të Vendimit të organit administrative apo gjyqësor, bëhet duke paguar taksën – tarifën në shumë prej:	50.00
------	---	-------

Regjistrimi i pronësisë, posedimit, në bazë të pjesëtimit (ndarjes) të pronës në bashkëpronësi

8.77	Regjistrimi i pronësisë, i posedimit në bazë të pjesëtimit (ndarjes) të pronës në bashkëpronësi bëhet duke paguar tarifën në shumën prej 20 € për një akt juridik me të cilin është vendosur bashkëpronësia.
8.78	Regjistrimi i pronësisë, i posedimit në bazë të pjesëtimit (ndarjes) fizike të pronës nga bashkëpronësia,pagesa bëhet duke paguar nga 20 € nga secili bashkëpronarë që bëhet pronar individual nga pjesëtimi fizik i pronës
8.79	Për regjistrimin e pronës së përbashkët bëhet duke paguar tarifën në shumë prej 20 € për një akt juridik me të cilin është vendosur prona e përbashkët.
8.80	Regjistrimi i pronësisë së përbashkët të ndërtesave në bashkëpronësi bëhet duke paguar tarifën në shumë prej 20 €
8.81	Regjistrimi i pronësisë së përbashkët të ndërtesave në bashkëpronësi me të gjithë pronarët e pjesëve të veçanta bëhet duke paguar tarifën në shumë prej 100 € .

Regjistrimi i pronësisë, posedimit, në bazë të Trashëgimisë dhe të shkëputjes së bashkësisë familjare.

8.82	Regjistrimi i pronësisë, posedimit në bazë të Trashëgimisë bëhet duke paguar tarifën në shumën prej 10 € për çdo trashëgimtar.
8.83	Regjistrimi i pronësisë, posedimit në bazë të shkëputjes së bashkësisë familjare bëhet duke paguar tarifën në shumën prej 10 € për çdo anëtarë të familjes që bëhet pronar, posedues.

Regjistrimi i pronësisë, posedimit, në bazë të ndërrimit të pronës së paluajtshme.

8.84	Regjistrimi i pronësisë, posedimit, në bazë të ndërrimit të pronës së paluajtshme, bëhet duke paguar tarifën në shumën prej 30 € për secilin pronar – posedues.
------	---

REGJISTRIMI I HIPOTEKAVE

Regjistrimi i Hipotekave do të bëhet sipas vlerave të kërkesave (kredive) të përcaktuar me dokumentin e hipotekës dhe atë:		
8.85	Kërkesa (kredia) në vlerën prej 10,000 € paguhet taksa – tarifa në shumën prej:	10.00
8.86	Kërkesa (kredia) në vlerën prej 10,000 € - 30,000€ paguhet taksa – tarifa prej:	20.00
8.87	Kërkesa (kredia) në vlerën prej 30,000 € - 50,000€ paguhet taksa – tarifa prej:	30.00
8.88	Kërkesa (kredia) në vlerën prej 50,000 € - 100,000€ paguhet taksa – tarifa prej:	80.00
8.89	Mbi vlerën 100,000 €, për çdo 100,000 € tejkalim paguhet edhe nga 30 € por shuma e tarifës – taksës nuk mund ta kalojë vlerën financiare mbi 400 €.	
NDRYSHIMI DHE FSHIRJA E HIPOTEKAVE		
8.90	Ndryshimi i hipotekës së regjistruar bëhet duke paguar tarifën në shumë prej 30 €	30.00
8.91	Për fshirjen e Hipotekës nga Regjistri i të Drejtave mbi pronën e Paluajtshme duhet të paguhet taksa – tarifa në shumën prej:	10,00
REGJISTRIMI I SERVITUTEVE		
8.92	Regjistrimi i të drejtës së Servitutit në Regjistrin e të drejtave mbi pronën e paluajtshme bëhet duke paguar tarifën në shumë prej:	50.00
8.93	Fshirja e Servitutit nga regjistri bëhet duke paguar tarifën në shumën prej	20.00
REGJISTRIMI I TË DREJTËS SË SHFRYTËZIMIT – QIRAMBAJTJA		
8.94	E drejta e shfrytëzimit – Qirambajtje me kohëzgjatje prej 3 deri në 10 vite mund të regjistrohet duke paguar tarifën në shumën prej:	50.00
8.95	E drejta e shfrytëzimit – Qirambajtje me kohëzgjatje prej 10 deri në 25 vite mund të regjistrohet duke paguar tarifën në shumën prej:	150.00
8.96	E drejta e shfrytëzimit – Qirambajtje me kohëzgjatje deri në 99 vite mund të regjistrohet duke paguar tarifën në shumën prej:	500.00
8.97	Fshirja e të drejtës së shfrytëzimit – Qirambajtja bëhet duke paguar 20% e shumës që është paguar për regjistrimin e të drejtës së shfrytëzimit.	
8.98	Me rastin e bartjes së të drejtës së shfrytëzimit – Qirambajtjes ose nënqiran tek personat e tretë paguhet tarifa e cila është e përcaktuar nën nenin 2. e 3. të këtij Udhëzimi administrativ.	
REGJISTRIMI I BARRAVE DHE NGARKESAVE TË NDRYSHME		
8.100	Për regjistrimin e barrës tatimore bëhet duke paguar tarifën në shumë prej 30 € .	
8.101	Për regjistrimin e masës së sigurisë (masa e përkohshme) që procedura gjyqësore ose ndonjë procedurë tjetër është udhëhequr me kërkesë private të palës duhet të paguhet tarifa prej 50 €.	
8.102	Për regjistrimin e masës së sigurisë (masa e përkohshme) që procedura gjyqësore ose ndonjë procedurë tjetër është udhëhequr sipas detyrës zyrtare nga një organ kompetent për zbatimin e ligjit (Prokuroria, policia e tjera.) nuk do paguaj asnjë tarifë.	
8.103	KORIGJIMI I TË DHËNAVE NË REGJISTER Nëse të dhënat që duhet të korrigjohen janë futur në regjistrin si pas dokumentacionit të dorëzuar nga palët korrigjimi bëhet duke paguar pala 20 €.	

8.104	Nëse të dhënat që duhet të korrigjohen janë futur në regjistër me veprimin e ZKK-ës ose nga AKK-ja, korrigjimi bëhet pa pagesë.	
REGJISTRIMI I TË DREJTAVE TJERA		
8.105	Regjistrimi i të drejtave tjera mbi pronën e paluajtshme e të cilat nuk janë përfshirë me dispozitat e këtij Udhëzimi Administrativ do të regjistrohen	40.00

Neni 9

- 9.1. Për punët në teren prej 15 nëntorit deri më 15 mars çmimet janë më të larta për 25%
- 9.2. Për punët dhe shërbimet që do të kryhen në tokat pyjore çmimet do të jenë më të larta për 30%.
- 9.3. Pala duhet të sigurojë transportin dhe punëtorët ndihmës për kryerjen e punëve në teren.
- 9.4. Me prezantimin e dokumenteve të dëshmisë, anëtarët e ngushtë të familjeve të dëshmorëve, invalidët e luftës dhe anëtarët e ngushtë të familjeve të tyre, veteranët e luftës dhe anëtarët e ngushtë të familjeve të tyre, anëtarët e ngushtë të familjeve të viktimave civile të luftës, personat me aftësi të kufizuar dhe personat që realizojnë ndihma sociale me këtë rregullore do të lirohen nga pagesa e tarifave nga neni 8 pika 8.49 dhe 8.50. të kësaj rregullore.

Pjesa 4 : Tarifat dhe ngarkesat për ndërtim dhe urbanizëm

Neni 10

Të bëhet përshkrimi i vijës kufitare të zonave të ndërtimit

10.1	Lejet e ndërtimit dhe rregullimi i tokës ndërtimore	
10.1.1	Objektet individuale të banimit, Objektet bujqësore, Objektet prodhuese – industriale (për m ²):	3.00
10.1.2	Për legalizimin e objekteve individuale të banimit	3.00
10.1.3	Objektet kolektive të banimit, objektet e biznesit	3.00
10.1.4	Për legalizimin e objekteve (lokaleve) afariste	3.00
10.1.5	Pompat e benzinës (për m ³ të kapacitetit të rezervarëve të derivateve)	7.50
10.1.6	Fushat e përkohshme sportive	300.00
10.1.7	Vendosja e antenave – transmetuesve si telefonisë, celulare, fikse, internetit .	300.00
10.1.8	Për centralet elektrike me fuqi prodhuese të rrymës deri në 20 MWh	1000.00/€MWh
10.1.9	Për pishinat verore	2.00/m ²
10.1.10	Për bazene për kultivim të llojeve të ndryshme të peshqve	2.00/m ² .
10.1.11	Për shndërrimi e lokaleve banesore në lokale afariste (ndërrim i destinacionit në sektorin privat apo shtetërore për m ²)	3.00
10.1.12	Mbi ndërtimi dhe shndërrimi i hapësirave të përbashkëta në banim	3.00
10.1.13	Tarifa rregullative për ritjen e densitetit të infrastrukturës (për m ² /kokë banori)*	96.72

Tarifës sipas pikës 10.1.3 vlen edhe për objekte përcjellëse

*10.1.13. Kjo tarifë sipas ligjit të ndërtimit bëhet me marrëveshje të posaçme me pronarin.

10.2	Tarifat dhe ngarkesat për lejet mbi shfrytëzimin e objekteve caktohen në lartësi prej 20% të vlerës së tarifave dhe ngarkesave për leje ndërtimi
10.3	Qiraja në pronësi të lokaleve pronë e K.K. Mamushes (për m ² /muaj):

	Sipërfaqja deri ne 50 m ²	2.50
	Sipërfaqja deri ne 100 m ²	2.00
	Sipërfaqja me mbi 100 m ²	1.50
10.3.1	Sipërfaqet ndihmëse të lokaleve (kuzhinat, depot etj)	0.50
10.4	Qiraja për shfrytëzimin e tokës, pronë e komunës për biznes	
10.4.1	Objektet e përkohshme (për m ² / muaj):	
	Zona I	0.60
	Zona II	0.50
	Zona III	0.40
	Zona IV	0.30
Qiraja sipas pikës 10.4.1. vlen për katin përdhes. Për katet tjera vlera e qirasë llogaritet sa 50% e qirasë për katin përdhes.		
Vërejtje: Përgjatë rrugëve magjistrale dhe rajonale qiraja për shfrytëzimin e tokës pronë e Komunës për qëllime biznesi është sikurse në zonën I – e parë.		
10.4.2	Qiraja për shfrytëzim të tokës ndërtimore për banim dhe destinim tjetër (Për m ² / në vit)	
	Për banim	0.50
	Për garazha	2.00
	Për destinim tjetër – Parkim	2.00
10.4.3	Qiraja për dhënien në shfrytëzim të objektit për banim-prone Komunale m ² /muaj	0.30€
10.5	Për lëshimin e vërtetimit në caktimin e vlerës së objektit:	
	Për objektet deri më 100 m ²	10.00
	Për objektet prej 101 – 500m ²	20.00
	Për objektet prej 501 – 1000m ²	30.00
	Për objektet prej 1001 – 2000m ²	40.00
	Për objektet më të mëdha, për çdo 1000 m ² , tarifa rritet për	10.00
* Vlerësimi bëhet nga Komisioni për vlerësime të pasurisë i formuar nga Kryetari;		
10.6	Për daljen në teren sipas kërkesave	10.00
Vërejtje: Këtu përjashtohen rastet e daljes në teren gjatë shqyrtimit të kërkesave për leje ndërtimi dhe për leje shfrytëzimi.		
10.7	Pagesa për leje rrënimi	10.00
10.8	Pagesa për leje pune	10.00
10.9	Për dhënien e Pëlqimeve të ndryshme	10.00
10.10	Për ndarje fizike të ngastrës kadastrave	10.00
10.11	Lëshimi i vërtetimeve të ndryshme	1.00
10.12	Pagesa për aplikim për leje përdorimi	5.00
10.13	Pagesa për dalje në vendshqim për konstatim profesional	20.00
10.14	Lëshim i vërtetimit mbi shkallën e dëmtimit	1.00

Neni 11

Masat ndëshkuese apo dënimet të cilat duhet t'i zbatoj zyrtari i deleguar, përkatësisht Inspektori i ndërtimtarisë janë të përcaktuara me Ligjin mbi Ndërtimin , të miratuar në Kuvendin e Republikës së Kosovës.

Neni 12

12. Taksat dhe tarifat për dhënien e lejes mjedisore komunale

